



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

PROCESVERBALI I DËGJIMIT PUBLIK PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (2023-2025) NË SEKTORIN E ARSIMIT DHE TË SHËNDETËSISË

Drejtori për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani i përshëndet të pranishmit duke ju uruar mirëseardhje, në dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës.

Drejtori Osmani e hap dëgjimin publik “komuna e Podujevës është në proces të hartimit të Kornizën Afatmesme Buxhetore që përfshin vitin 2023-2025, në këtë kornizë paraqiten projektet dhe prioritetet kryesore të cilat i kanë qytetarët e Podujevës gjatë këtyre 3 viteve”.

Drejtori Osmani tha se jemi në vazhdën e dëgjimeve publike të cilat i kemi mbajtur në disa fshatra dhe tani jemi në dëgjimet publike që do t'i mbajmë në qytet dhe sot është dëgjimi për dy sektor të rëndësishëm, arsimin dhe shëndetësinë.

Buxheti i Komunës së Podujevës në bazë të Qarkores buxhetore nga Ministria e Financave për vitin 2023 ka një rritje mbi 4 mil. euro në total, do të thotë është rrith 27 mil. euro për dallim nga 23 mil. rritje e konsiderushme në 2023 por do të vazhdojë kjo rritje në mënyrë progresive edhe në vitin 2024 dhe 2025.

Sektori i Arsimit dhe i Shëndetësisë janë prioritari në komunën e Podujevës, arsyja e takimit të sotëm është t'i marrim komentet dhe sygjerimet e juaja. Buxheti i Shëndetësisë i lëshuar nga Ministria e Financave për vitin 2023 është mbi 3 mil.euro, ku me këtë buxhet besojmë që do t'i përbushim nevojat e sektorit primar të shëndetësisë, ku mbi 845 mijë euro janë në katégorinë e mallrave, 150 mijë euro janë në kategorinë e subvencioneve ku kemi edhe rritje afër 50%, dhe në investime kapitale janë mbi 58 mijë në draftin fillestar, ku në projketet e shëndetësisë parashihet ndërtimi i urgjencës së qytetit në lagjen te Besiana në bashkëpunimin me shtetin e Katarit dhe shumë projekte tjera në sektorin e shëndetësisë.

Sipas Qarkores investimet kapitale në Arsim janë 112 mijë euro mirëpo me planifikimet tona në sektorin e arsimit ne kemi nda mbi 1millionë euro, bëhet fjalë për afro 15 herë më shumë buxhet sesa që parashuh Qarkorja Buxhetore. Sa i përket kategorisë së mallrave në vitin 2023 parashohim mbi 1 millionë euro dhe besojmë që të gjitha nevojat e sektorit të arsimit të mbulohen me këto mjete.

Tek investimet kapitale në Arsim ka filluar ndërtimi i shkollës së fshatin Obrançë, ndërtimi i sallës te shkolla “Enver Maloku”, përmirësimi i infrastrukturës fizike shkolllore ku do të bëhen rinovime të institucioneve arsimore, ndërtimi i shkollës në Dumosh, si dhe në këto tri vite parashihet ndërtimi i një shkolle të mesmë në Komunën e Podujevës, ndërtimi i sallave të edukatës fizike si dhe do t'i marrim edhe propozimet e juaja. Projekt do tjetër do të jetë digitalizimi i shkollave, ku për tabelat digitale kemi nda 700 mijë euro ku brenda këtyre dy viteve çdo klasë në komunën e Podujevës do ta ketë tabelën digitale, dhe çdo land mësimore do të ketë mjetet e konkretizimit dhe kabinetet përkatëse.

Kjo ishte një rrumbullaksim i shkurt për këta dy sektor dhe tani dua t'ua kalojë juve mundësinë e kontributit me propozime dhe sygjerime.

Drejtori i shkollës "Zahir Pajaziti", të fshatit Orllan, ka kërkesë ndaj drejtorit të Arsimit për ndërtimin e një salle të sportit, për rrethoja të shkollës, si dhe pullazin e shkollës i cili thotë se është shumë i dëmtuar, dëpërtion uji brenda kur ka reshje, gjithashtu kërkesë ka edhe për shkallët e shkollës që janë në gjendje aspak të mirë. Objekti i shkollës së vjetër, është mirë t'i bëhet destinimi nga ju, jo për tu rrënuar sepse lidhet ngushtë me historinë, me kulurën, sportin, dhe mund të bëhet qendër trajnimi.

Drejtori i shkollës "Emin Duraku" në Bajçinë, thotë se është ndërtu një shkollë mjaftë e mirë, një shkollë bashkëkohore, mirëpo kemi nevojë edhe për kabinete, kabinetin e informatikës, bibliotekë, të bëhet funksionalizmi i kabinetit të shkencave, si dhe ndërtimi i një depoje për pelet.

Drejtori Mustafë Miftari, nga shkolla "Lasgush Pogradeci" Dumincë, thotë se kërkesa dhe prioriteti jonë janë ndërtimi i një fushe të vulejbollit, prioritet shtrimi i parkingut pranë shkollës.

Drejtori i gjimnazit "Aleksandër Xhuvani" Liridon Mulliqi, i falënderoi për mundësin e propozimeve për të gjitha shkollat, ku tha se ne si shkollë kemi disa kërkesa, kemi nevojë për investim në oborrin e shkollës së Gjimnazit, sepse hapësira është e madhe por duhet të shtohen hapësirat e gjelbërtë, te salla e edukatës fizike na nevojiten pajisje për sporte, rrethoja e shkollës një pjesë ka mbetur pa rrinovuar. Te fushat e sportit është e nevojshme shtrimi i dyshemes me beton sepse kur ka reshje shiu është problem të realizohen orët mësimore.

Edhe pse jemi furnizuar me kompjuterë ne kabinete mendojmë që është e nevojshme krijimi edhe i një kabineti për shkak se numri i nxënësve është i madh të cilët mësojnë lëndën e tikut. Kemi problem me kulmin e shkollës, sidomos kur ka shi, nuk mundemi me realizuar punën si duhet. Në aspektin e cilësisë së mësimit presim edhe investime në fushën e ofrimit të trajnimeve-programeve për mësimdhënës, presim mbështetje nga ju apo organizatat tjera.

Drejtori i shkollës "Kadri Kadriu" në Llaushë, Ismet Halimi, kërkesa e tij për investime si shkollë me dy paralele të ndara, kemi nevojë për rrethoja të shkollës sepse ato janë mjaft të dëmtuara, rrethojat tek fusha sportive cila na paraqet probleme për zhvillimin e aktivitetave sportive, kemi nevojë për meremetimin e shkallëve të shkollës të cilat janë dëmtuar shumë, dhe për meremetimin dhe gëlqerosjen e klasëve të cilat janë dëmtuar bukur shumë.

Tek objekti tjetër i shkollës së re, kemi nevojë për furnizimin e kabinetave të teknologjisë, fizikës, biologjisë etj.

Drejtori i shkollës së Bradashit, Fadil Zymeri, jam drejtor i dy paraleleve të ndara me numrin më të madh të nxënësve në nivel komunal me përjashtim të qytetit. I kam disa kërkesa për juve, shkolla amë në Bradash është ndërtuar në vitin 1972, rrinovimet e sajë nuk janë në mënyrë të rregullt, kulmi nuk është rrinovuar mirë, në shkollën tonë invertari është në gjendje shumë të dëmtuar, mjetet teknologjike nuk i kemi asnjë, skemi printer për teste na nevojitet. Por invertari është kryesor që na mungon.

Drejtori i shkollës "Shefki Latifi" në Pollatë, kërkesat tona janë të kamotshme, shkolla jonë është ndërtuar në vitin 2000-2001, do të thotë kemi kabineti por na mungojnë pajisjet kompjuterike. Prioritet tjetër është rrethoja e shkollës sepse është e dëmtuar, te fusha e sportit është bërë një intervenim i vogël por nuk është në nivel të kënaqshëm.

Drejtori i shkollës "Sheqë Miroci" në Shtedim, tha edhe ne si shkollat tjera i kemi disa kërkesa, por tani do t'i prezantojmë, kemi platon para hyrjes së shkollës ka qenë e ndërtume me beton dhe tani është dëmtuar pothuajse fare, kur bie shi depërtion brenda shkolle, kemi nevojë për ndërtimin e një salle të edukatës fizike, një pjesë tjetër na duhen vendosja e disa gypave dhe intervenimi me zhavor për shfrytëzim si parking si dhe evitohet rreziku i nxënsave sepse mund të bien, kemi nevojë për ndërtimin e një depoje sepse drutë gjatë stinës së dimrit po ngrihen nga moti dhe si të tilla nuk ndizen. Na mungon biblioteka e shkollës, gjithashtu kabineti i informatikës na mungon.

Drejtori i shkollës "Ali Hadri" në Obrançë, Nysret Ismajli, tha që në kuadër të kësaj shkolle funksionojnë edhe paralelet e ndara në Katunishtë dhe në Peran. Fillimisht ju falënderoj për vendosjen e priorititetit për ndërtimin e shkollës në Obrançë, e di që është në procedura të prokurimit, por kam një kërkese për ndërtimin e sallës sportive e cila do të shërbej për tri shkollat tona, që të ndërtohet në shkollën e Peranit, të ndahet një buxhet për stimulimin e nxënëseve që kur marrin pjesë në gara dhe dalin të parët, mos të marrin vetëm një letër por të kenë një kompensim shpeshtë, në mënyrë që nxënësit kur të arrijnë sukseset e theksura.

Drejtori i shkollës së Gllamnikut, Sadat Avdullahu, kërkesa ime e cila është adresuar edhe në drejtorin e Arsimit, është ndërtimi i një sallë sportive, kemi kërkesa për investime për paralelen e ndarë në Sekiraq, e cila nevojitet një rrrethoje e cila sjell siguri për nxënësit sepse shkolla gjindet pranë lumit Llap.

Drejtori i Arsimit, Avni Fetahu, falënderoi të pranishmit për kohën dhe kërkeshat shumë të nevojshme për shkollat e tyre, sallat e edukatës fizike janë shumë të arsyshme por edhe pak të kushtushme. Cështja e kulmit të shkollave dhe intervenimit që u potencua, vitin e kaluar me një buxhet mjaft simbolik kemi arritur të intervenojmë në 32 shkolla, ndërsa tani prap parashohim rregullime dhe rinovime të disa shkollave. Te objektet për pelet na kemi planifikuar këtë vit, duke marr parasysh kërkeshat e juaja, pajisjet për teknologjike informative, e kemi patur një specifik sepse ka qenë një kontrat një OSHP që nuk ka marrur një epilog të caktuar, mirëpo fat është i mirë që jemi koncentruar te tabelat e mencuara, sepse me këto mund të bëhem komuna e parë që mund të kemi pothuajse cdo klasë një table të muncur. Kanë mbet edhe 13 shkolla për finalizimin e kabineteve fizikë, biologji dhe kimi, tani jemi në prag të nënshkrimit të kontratës. Sipas rregullores së re cdo nxënës dhe mësimdhënës i cili ka arritur një sukses të theksuar kanë mundësin e shpërbimit.

Drejtori Osmani: Në rast se nuk keni dicka për të shtuar ju mund ti adresoni kërkeshat edhe juve me shkrim, dhe ne do t'i trajtojmë sipas mundësive. Me ketë buxhet që kemi tani besoj që kërkeshat tuaja do t'i zgjidhim.

Dëgjimi publik është transmetuar direkt në rrjetin social facebook dhe në ueb faqen zyrtare.

Dëgjimin mund ta gjeni në vegëzën e mëposhtme;

<https://eeë.facebook.com/KomunaEPodujeves/videos/1259714138189427>

08.06.2022, Podujevë

X f

LIVE




FATLUM OSMANI - Drejtor i Financave

1:17

▶ 1:15 / 48:29



f



f

LIVE

A small white rectangular logo with the letters "TV" in black, positioned on the left side of the video frame.

x f


LIVE



API



23:46 / 48:29



f

